

PAKTI TERRITORIAL I PUNËSIMIT

Komuna e Dragashit



Empowered lives.
Resilient nations.

United
Nations
Development
Programme

Dragash
**GRUPI LOKAL I
VEPRIMIT**

Komuna e Dragashit



Komuna e Dragashit dhe UNDP në emër të grupit lokal të veprimit, shpallin këtë

THIRRJE PËR APLIKIM

Komuna e Dragashit dhe UNDP, në kuadrin e zbatimit të projektit të financuar nga Bashkëpunimi Austriak për Zhvillim (ADC), "Zhvillimi i Integruar Territorial 2" (InTerDev 2), kanë zhvilluar një Pakt Territorial të Punësimit (PTP), i cili synon të promovojë krijimin dhe formalizimin e punësimit për individë të cënueshëm në komunën e Dragashit si mjet për të promovuar rritjen dhe valorizimin e territorit. Përmes kësaj iniciative projekti synon të promovojë rritjen inkluzive dhe të vlerësojë territorin. PTP i Komunës së Dragashit promovon 5 veprime të parashikuara për të siguruar mbështetje për qytetarët në komunë.

Ky intervenim PTP është projektuar për të mbështetur 4 familje rurale (fshati Restelicë dhe fshati Radeshë (rajoni Gorë), fshati Brezne dhe fshati Zaplluxhe (rajoni Opojë) për të filluar/përmirësuar një aktivitet ekonomik në turizmin rurale duke i shëndërruar shtëpitë e tyre në bujtina për mysafirë. Përfituesit marrin një grant për të përmirësuar kushtet e dhomës së një mysafiri (me infrastrukturë të dedikuar sanitare) Përveç kësaj, anëtarët e familjes marrin trajnim për shërbimin e mikpritjes dhe turizmit Të gjitha bujtinat janë promovuar përmes kanaleve të ndryshme, duke përfshirë pjesëmarrjen në panaire.

Komuna e Dragashit dhe UNDP ftojnë individë të interesuar që plotësojnë kriteret e përshkruara më poshtë për të aplikuar.

Kriteret e përshtatshmërisë

- Të jeni banorë të fshatrave të përzgjedhura - që aktualisht nuk jetojnë në qytet (të verifikueshme me certifikatë familjare);
- Të jeni familje me së paku 2 anëtarë të moshës së punës (+16 vjeç) (të verifikueshme me certifikatën e familjes);
- Aktualisht jetoni dhe banoni në shtëpinë ku parashihen të priten turistët (të verifikueshme me dokument të pronës, mund të jenë në emër të aplikantit, të prindërve të tij ose të gjyshërve)
- Shtëpia aktualisht nuk shërben si bujtinë por është e banuar (të verifikohet nga stafi i UNDP-së);

- Shtëpia ka të paktën një dhomë gjumi shtesë (dhomë mysafirësh) dhe një minimum prej dy banjosh (objekte dushi në dhomë të dedikuar për mysafirët është i detyrueshëm);
- Të paktën një anëtar i familjes i regjistruar si punëkërkes i papunë

Ju njoftojmë se këto janë kritere kualifikuese. Kjo do të thotë që nëse nuk përputhesh me njërin prej këtyre, do të diskualifikohesh gjatë kontrollit të kualifikimit dhe nuk shqyrtoheni më tutje për vlerësim. Nëse keni dyshime për një ose më shumë kritere kualifikuese, ju lutemi konsultoni informacionin e dhënë në dosjen e aplikacionit.

Prioriteti për këtë Thirrje për Aplikim i jepet:

- Familjeve me anëtarë që jetojnë në komunë që janë të moshës 16-29 vjeçare (5 pikë shtesë)
- Aplikantët të cilët zotërojnë një shtëpi që ka më shumë se një dhomë në dispozicion për mysafirët (4 pikë).

Nëse do të përzgjidheni, do të përfitoni si më poshtë:

- Shërbimet e këshillimit dhe zhvillimit të biznesit (BADS)
- Qasja në mundësitë e trajnimit (A2TO);
- Qasja në mundësitë e kreditimit (A2CO);

Mbështetja është e kushtëzuar me formalizimin e përfituesve.

Deri në 4 (individe/familje) do të përfitojnë nga ky intervenim.

Si të merrni Formularin e Aplikimit:

- Merrni kopjet e formularëve të aplikimit në zyrën e Projektit InTerDev 2 (në Zyrën e Komunës së Dragashit)

Nëse keni nevojë për ndonjë sqarim ose ndihmë të mëtejshme për të plotësuar formularin e aplikimit ju jeni të ftuar të merrni pjesë në Ditën e Informimit të organizuar nga Komuna e Dragashit dhe UNDP-ja në datën: 02/04/2019, koha: 11:00 dhe vendi: Zyra e projektit InTerDev 2 në Dragash.

Formularët origjinal të aplikimit duhet të dorëzohen, në kopje, në zyrën e Projektit InTerDev 2 në komunën e Dragashit para (data: 16/04/2019 koha: 15:00) .

KUJDES: Ju lutemi mos harroni të merrni dokumentin që vërteton se e keni dorëzuar Formularin e Aplikimit dhe dokumentet shoqëruese në kohën e duhur.

JU LUTEMI NA NDIHMONI të promovojmë këtë Thirrje për Aplikime duke informuar njerëz të tjerë që mendoni se mund të kenë interes të aplikojnë për këtë mundësi.